KFA023	27 400	-	-	-	27 400
KFA001	24 000	-	-	-	24 000
KFA034	23 960	-	-	-	23 960
KFA015	22 000	-	-	-	22 000
KFA008	21 901	-	-	-	21 901
KFA033	20 130	-	-	-	20 130
KFA016	17 500	-	-	-	17 500
KFA073	17 500	-	-	-	17 500
KFA074	17 500	-	-	-	17 500
KFA029	16 400	-	-	-	16 400
KFA051	15 000	-	-	-	15 000
KFA079	15 000	-	-	-	15 000
KFA028	12 340	-	-	-	12 340
KFA025	12 000	-	-	-	12 000
KFA036	12 000	-	-	-	12 000
KFA014	11 550	-	-	-	11 550
KFA049	7 000	-	-	-	7 000
KFA026	6 600	-	-	-	6 600
KFA041	6 000	-	-	-	6 000
KFA011	4 112	-	-	-	4 112
KFA020	4 000	-	-	-	4 000
KFA056	3 150	-	-	-	3 150
KFA044	2 750	-	-	-	2 750
KFA059	2 450	-	-	-	2 450
KFA064	2 450	-	-	-	2 450
KFA065	2 100	-	-	-	2 100
KFA067	1 050	-	-	-	1 050
KFA053	700	-	-	-	700
KFA075	500	-	-	-	500
Shumë	2 479 382				2 479 382

DETYRIM I VJETER SHLYER "PELOYESHEM"					
KFA038	161 850	-	100 000	(100 000)	61 850
KFA022	101 050	-	60 000	(60 000)	41 050
KFA062	133 500	-	130 000	(130 000)	3 500
KFA061	123 500	-	120 005	(120 005)	3 495
KFA040	77 500	-	70 000	(70 000)	7 500
KFA063	63 500	-	60 000	(60 000)	3 500
KFA013	62 000	-	60 000	(60 000)	2 000
KFA052	42 275	-	40 000	(40 000)	2 275
SHUMI	765 175	-	640 005	(640 005)	125 170
DETYRIM I VJETER SHLYER PLOTESISHT					
KFA045	123 215	(123 215)	-	(123 215)	-
KFA037	60 000	-	60 000	(60 000)	-
KFA043	60 000	-	60 000	(60 000)	-
KFA047	60 000	-	60 000	(60 000)	-
KFA050	60 000	-	60 000	(60 000)	-
KFA058	120 000	-	120 000	(120 000)	-
KFA068	120 000	-	120 000	(120 000)	-
KFA071	60 000	-	60 000	(60 000)	-
KFA072	60 000	-	60 000	(60 000)	-
KFA078	60 000	-	60 000	(60 000)	-
KFA081	60 000	-	60 000	(60 000)	-
KFA082	60 000	-	60 000	(60 000)	-
KFA084	40 000	-	40 000	(40 000)	-
KFA085	60 000	-	60 000	(60 000)	-
KFA086	40 000	-	40 000	(40 000)	-
KFA087	27 990	-	27 990	(27 990)	-
KFA088	14 136	-	14 136	(14 136)	-
KFA089	1 310	-	1 310	(1 310)	-
KFA093	-	-	29 366	(29 366)	(29 366)
	1 086 651	(123 215)	992 802	(1 116 017)	(29 366)
TOTALI I llog 411	5 470 698	870 000	2 012 807	(1 142 807)	4 327 891

Nga tabelat e mësipërme rezulton që janë arkëtuar llogari të të drejtave të mbartuara (çeljes) në pasqyrën e pozicionit financiar të IEKA-s, për kuotën fikse në datën 31.12.2023, në masën 37,64%. Mbetet pa u arkëtuar për llogari të çeljes, vlera prej 3,334,676 lekësh.

- Të drejtat e IEKA-s ndaj AL-ve pasivë jepen në llogaritë kontabël të numërtuar me llogarinë prind 413:

09.05.2024 14.43.32						
dt.	dt 01/01/2023 - 31/12/2023, llog 413 -					
klient	pershkrim	fillim	levizje te periudhes		fund	
		periudhe	faturim	likujdim	diference	periudhe
KFP004- KFP174		3 426 319	1 115 335	36 976	1 078 359	4 504 678

Janë arkëtuar për llogari të të drejtave të mbartura (çeljes) në pasqyrën e pozicionit financiar të IEKA-s, ndaj AL-ve pasivë (që nuk e ushtrojnë profesionin e audituesit ligjor) në datën 31.12.2023, në masën 2,1 % (V.O: janë arkëtuar 71,400 lekë gjithsej. Vlera 36,976 lekë është shumë algjebrike si rrjedhojë e mbipagesave të mbartura në çelje e që i zbriten për llogari të detyrimeve të vitit 2023). Mbetet pa u arkëtuar për llogari të çeljes, vlera prej 3,389,343 lekësh.

Në total, llogaritë e të drejtave të arkëtueshme 411-415 për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, paraqiten:

dt. klient	Lek Shqiptar dt 01/01/2023 - 31/12/2023 perskrim	fillim			diference	faqe fund
		peridhe	levizje te peridhes faturim	likujdim		
		20 842 530	13 335 727	11 386 412	1 949 315	22 791 845

Në shënimet shpjeguese nuk jepen informacionet për shkallën e arkëtueshmërisë të të drejtave të mbartura.

IEKA përdor sot llogaritë e grupit 41 për praqitjen e të drejtave të arkëtueshme.

Vazhdon skema e kontabilizimit të kontributeve sipas kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara (konceptimi dhe kontabilizimi i të cilave duhej të përcaktohej saktë sipas kërkesave të SKK-së për OJF-të që pas datës 01 janar 2016).

3. Kontrolli për AAM-të

Nga kontrolli i llogarive të AAM-ve, shohim këtë gjendje:

- Është kryer inventarizimi fizik i AAM-ve dhe është bërë dhe regjistrimi në kontabilitet sipas inventarit fizik;
- Aktivët afatgjata materiale janë hedhur si inventar në programin e kontabilitetit. Regjistrimet e hyrjeve janë bërë sipas faturave të blerjeve që nga viti 2012;
- Për amortizimin e akumuluar është pranuar vlera e kontabilitetit, pa kryer llogaritjet përkatëse sipas një politike amortizimi.
- Mungesa e regjistrimeve, ndër vite, në programin e kontabilitetit, të vlerave të llogaritura drejt të amortizimit dhe mungesa e dhënies së informacioneve për normat e zbatuara për llogaritjet e amortizimit, po ndër vite, bën që vlera e aktiveve neto e paraqitur në pasqyrat financiare, sot, të mos ketë sigurinë e duhur për raportim të drejtë të tyre.
Siç është shkruar dhe në raportin e KKB-së të vitit 2022, nga kontrolli i llogaritjeve të amortizimit, sipas shënimeve të paraqitura në tabelat e excelit të inventarëve fizikë të AAM-ve me dt. 30.06.2022, është parë që normat e amortizimit janë zbatuar mbështetur në vitet e përlllogaritura të jetës së dobishme të AAM-ve, të llogaritura prej IEKA-s.
- Siç është shkruar edhe në raportin e KKB-së të vitit 2022, sipas statutit të IEKA-s, në kapitullin 4 “Këshilli i Drejtimit” nen 15, nënpika 15.2.15 të tij, i ndryshuar, KD “Mban përgjegjësi për administrimin e pasurisë së Institutit...”. Në këtë kuadër, KD-ja duhet të përcaktojë nëse e quan të drejtë pranimin e vlerave të amortizimit të akumuluar sipas kontabilitetit deri me dt. 31.12.2021.
- Gjithashtu, duhet të vendoset të bëhet rivlerësimi për përcaktimin e vlerës së drejtë të ndërtesës, pas një vlerësimi të drejtë të mundësive (shih raportin e KKB-së për vitin 2022).

4. Kontrolli i llogarive të shpenzimeve dhe i raportimit të tyre në pasqyrën e aktiviteteve.

Klasifikimi sipas funksionit i kostove përkatëse kërkohet të zbatohet nga të gjitha OJF-të, që do të thotë se IEKA duhet të japë informacion mbi kostot e shërbimeve në aspektin e klasave kryesore të programit të shërbimeve.

Në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit 2023, IEKA i ka dhënë sqarimet sipas klasave kryesore të programit të shërbimeve të saj.

Një analizë e plotë e burimeve dhe e përdorimit të tyre lexohet në kaitullin VI “Pajtuueshmëria e llogarive me buxhetin”

VI. Pajtuëshmëria e llogarive me buxhetin

Analiza për realizimin e zërave të buxhetit është bërë bazuar në buxhetin e propozuar për miratim nga Këshilli Drejtues (KD) me vendimin 37 datë 14 shtator 2023 dhe i miratuar në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme në datën 7 dhjetor 2023.

Nga një vështrim i përgjithshme mund të konkludohet se realizimi ka tejkaluar pritjet për sa i përket performancës buxhetore. Realizimi i burimeve/ardhurave është 104.6% e buxhetit ose 1,508 mijë lekë më shumë se buxheti, ndërkaq që përdorimet/shpenzimet janë 95.5% e buxhetit ose 1,444 mijë lekë më pak se buxheti. Si rrjedhojë, nga një teprice negative e parashikuar në buxhet, duke përfshirë dhe tarifën e BMP, IEKA e ka mbyllur vitin 2023 me një teprice pozitive në vlerën 1,078 mijë lekë përfshirë tarifën e BMP. Në tabelën më poshtë pasqyrohet ky rezultat.

Zëri	Buxheti	Realizimi	Realizimi ne%	Realizimi në vlerë absolute
Burimet	32,500,000	34,007,903	104.6%	1,507,903
Përdorime (Shpenzime)	32,260,000	30,815,819	95.5%	(1,444,181)
Shpenzime për tarifen 7% për BMP	2,000,000	2,114,532	105.7%	114,532
Teprica përfshirë Tarifen 7%	(1,760,000)	1,077,552	-61.2%	2,837,552

Teprica rezulton e ndryshme nga vlera e paraqitur në pasqyrat financiare dhe kjo diference vjen nga vlera e investimeve 1,114,800 lekë (aktive afatgjata), të cilat janë paraqitur si përdorime në realizimin e buxhetit, por nuk përfshihen si shpenzime në PF e vitit 2023. Shtesat në aktivet afatgjata lidhet me:

- Blerjen e softuerë -Financa 5 versioni i përditësuar në vlerën 331 mijë lekë
- Blerje pajisje informatike në vlerën 783 mijë lekë

Në vijim janë analizuar zërat e veçantë të të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara nga IEKA, për të kuptuar ecurinë dhe për të identifikuar devijimet, bazuar në të cilat duhet rishikuar buxheti i vitit 2024.

Tejkalimi i të ardhurave vjen si rezultat i burimeve të mëposhtme:

- Kuota variabël ¹të misionëve të realizuara nga AL. Ky zë është realizuar 122% ose 1,970 mijë lekë më shumë. Kuota variabël është vështirë, thuajse e pamundur të parashikohet me saktësi, pasi gjatë vitit IEKA nuk ka informacion mbi honorarët e faturuara nga AL, por mund të ecet me supozimin që kjo kuotë nga viti në vit nuk do të ketë rënie, për sa kohë nuk ka ndryshime ligjore që ta imponojnë një ndryshim të tillë. Në këtë kuadër, ky zë duhet rishikuar në projektbuxhetin e vitit 2024, duke e barazuar të paktën me realizimin e 2023. Aktualisht projekt-buxheti i 2024 është 91% e realizimit të vitit 2023.
- Të ardhura nga kualifikimet e AL i realizuar me 380% ose 1,119 mijë lekë. Në këtë zë janë përfshirë tarifat e marra nga AL për ndjekjen e orëve të kualifikimit të detyrueshëm profesional, të organizuar në seanca shtesë, përtej planifikimit standard të kualifikimit të detyrueshëm të organizuar nga IEKA për të gjithë AL.
- Të ardhurat nga depozitat e kursimeve e realizuar në masën 397% e buxhetit ose 297 mijë lekë më shumë. Në lidhje me këtë zë nuk mund të përcaktohet rritja reale. Buxheti është bërë mbi një

¹ Kuota variabël e llogaritur bazuar në shumën e honorareve të faturuara nga angazhimet e kryera për vitin, -0,5% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale nga 0-8 mln lekë dhe 0,3% e të ardhurave totale për nivelin e të ardhurave totale mbi 8 mln lekë.

shifër të mbartur ndër vite, pasi IEKA nuk kishte të drejta në llogaritë bankare të saj, për shkak të problematikave dhe konflikteve të pazgjidhura në lidhje me përzgjedhjen e KD së vitit 2021. Gjatë vitit 2023 është marrë akses në të gjithë llogaritë bankare dhe realizimi në vlerën 396.5 mijë lekë përfaqëson interesin real të përfutur për vitin 2023. Ndërkaq që interesat e viteve të kaluara janë njohur në ardhura në pasqyrat e rishikuara të vitit 2022.

- Në tabelën më poshtë paraqitet përmbledhja e pikave të mësipërme.

Zërat e Buxhetit	Projekt Buxheti 2023	Realizimi 2023	Realizimi në%	Realizimi në vlerë absolute	Projekt Buxheti 2024
Kuota variable e misioneve	9,000,000	10,930,277	122%	1,970,268	10,000,000
Burime (të ardhura) nga kual. AL	400,000	1,519,082	380%	1,119,082	400,000
Të ardhura nga depozitat e kursimeve	100,000	396,513	397%	296,513	100,000
Totali	9,500,000	12,885,863		3,385,863	10,500,000

Pjesa tjetër e burimeve janë realizuar në masën 92% të buxhetit ose në vlerë 1,937 mijë lekë më pak.

Për sa i përket përdorimeve apo shpenzimeve ato janë realizuar në masën 95.5. Më poshtë janë analizuar të gjithë zërat e shpenzimeve, të cilat kanë tejkaluar buxhetin dhe arsyet përkatëse dhe mund të përmbledhen si vijon:

- Shpenzime të paparashikuara të cilat kanë tejkaluar buxhetin përtej çdo pritshmërie. Më konkretisht buxheti për këtë zë është 100 mijë lekë, ndërkaq që realizimi është në vlerën 1,751 mijë lekë. Në këtë zë janë përfshirë shpenzimet si më poshtë:
 - Shpenzime gjyqësore në vlerën 1,280 mijë lekë të lidhura me çështje gjyqësore në proces ku IEKA është e paditur për ndërprerje të njëanshme të marrëdhënies së punësimit me një ish punonjës.
 - Gjoha dhe dëmshpërblime në vlerën 421 mijë lekë të cilat rezultojnë 405 mijë për kamatëvonesat e vendosura nga BMP në lidhje me pagesën e tarifës dhe pjesa tjetër 17 mijë për pagesa të vonuara të detyrimeve tatimore (*Kontribute, TAP, TB*), për shkak të mungesës së likuiditetit nga bllokimi i aksesit në llogaritë bankare.
 - Humbja nga çregjistrimi i aktiveve materiale të rezultuara në mungesë pas inventarit të kryer, në vlerën 50 mijë lekë.
- Shpenzimet për organizimin e Asamblesë dhe festën e fund vitit të cilat janë realizuar në masën 117% dhe janë 555 mijë lekë mbi buxhet. Ky zë ka tejkaluar buxhetin dhe për vitin 2022. Duke marrë parasysh historikun si dhe çmimet në rritje, duhet rishikuar ky zë në projekt buxhetin e vitit 2024.
- Shërbime nga të tretë, i cili është realizuar 374% të buxhetit ose 411 mijë lekë më shumë. Arsyet kryesore të rritjes së këtij zëri përtej buxhetit janë:
 - Rritja e tarifës së mirëmbajtjes së administrimit të ambienteve të përbashkëta.
 - Organizimi i Asamblesë së Federatës Mesdhetare të Eksperteve Kontabël ku IEKA është anëtar me të drejta të plota.

Duke marrë parasysh kostot e rritura, ky zë duhet rishikuar për buxhetin 2024.

- Shpenzime amortizimi të cilat janë realizuar në vlerën 117% të buxhetit ose 191 mijë lek më

shumë. Duke marrë parasysh regjistrin e aktiveve materiale dhe parashikimin për investime të reja, ky zë mund të kalkulohet me saktësi më të lartë. Gjithashtu, duhet rishikuar buxheti i vitit 2024 për këtë zë, për të përcaktuar vlerën e saktë bazuar në të dhënat më të fundit.

Në tabelën më poshtë paraqiten të përmbledhura zërat kryesorë të shpenzimeve të cilët kanë tejkaluar buxhetin.

Zërat e Buxhetit	Projekt Buxheti 2023	Realizimi 2023	Realizimi në%	Realizimi në vlerë absolute	Projekt Buxheti 2024
Shpenzime të paparashikuara	100,000	1,751,413	1751%	1,651,413	100,000
Shpenzime për Asamblenë+feste fundviti+25 vjet	600,000	1,155,400	193%	555,400	800,000
Shërbime në të tretë	150,000	561,184	374%	411,184	150,000
Totali	850,000	3,467,997	408%	2,617,997	1,050,000

Nga ana tjetër, nga mos realizimi i disa zërave të shpenzimeve mund të konkludohet në lidhje me aktivitetet e IEKA-s të cilat kërkojnë përmirësime. Më konkretisht zëri *“Honorare për Autoritete & Komitete”* është realizuar në masën 55% të buxhetit, me realizimin më të vogël:

- “Komiteti Programeve Alternative & Metodologjisë së Auditimit” me realizim 1.25% të buxhetit
- “Komiteti i Standardeve Profesionale dhe Etikës” me realizim 17% të buxhetit
- “Komiteti i Investigimit dhe Disiplinës” me realizim 39% të buxhetit
- “Komiteti i Kontrollit të Cilësisë për Auditimin Ligjor dhe Shërbimet e lidhura” me realizim 59% të buxhetit.

Mos realizimi i buxhetit në këto raste është një indikator i punës së munguar nga këto komitete, e cila do mund të kontribuonte në të mirën e të gjithë anëtarëve të IEKA-s .

Për më tepër, një mungesë totale e realizimit të buxhetit lidhet me botimet dhe përkthimet e standardeve të ndryshme dhe interpretimet e tyre, të cilat lidhen direkt me përditësimin dhe rritjen e aftësive dhe njohurive të anëtarëve të IEKA-s. Gjithashtu, buxheti i parashikuar për përkthimin e teksteve “Kaplan” apo “ACCA”, të cilët mund të jenë materiale reference për të gjithë stazhierët dhe persona të tjerë nuk ka pasur asnjë realizim.

VII. Konstatime dhe rekomandime

a) Konstatimet për zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin e KKB-së për veprimtarinë e IEKA-s për vitin 2021

Nga kontrolli i rekomandimeve të lëna në raportin e KKB-së për veprimtarinë e IEKA-s për vitin 2023 kemi këtë gjendje:

Rishikimi i rregullores për forcimin e disiplinës financiare për përdorimin e pasurisë së IEKA-s.

- Në përfundim të vitit 2023, nuk ka rregullore apo procedurë të krijuar apo të përditësuar në lidhje me aktivitetin administrativ të Organizatës, e cila do të rriste sigurinë në integritetin e transaksioneve dhe vazhdimësinë e punës, pavarësisht të gjitha lëvizjeve të mundshme në kapitalin njerëzor.
- Pavarësisht sa më lart, bazuar në rekomandimet e KKB-së për vitin 2022, nga ana e stafit ekzekutiv të IEKA-s është bërë një punë e detajuar për të identifikuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet e mbartura ndër vite, duke saktësuar vlerat të cilat duhet të jenë në pasqyrat financiare dhe duke bërë korrigjimet përkatëse në pasqyrat financiare të rishikuara për vitin 2022, kryesisht për të drejtat dhe detyrimet e mbartura. Në tabelën më poshtë paraqiten në mënyrë të përmbledhur ndryshimet e bëra sipas natyrës me vlerat përkatëse.

Përshkrimi	Efekti në Rritje / (Rënie)
Anullimi detyrimeve të IEKA-s ndaj anëtarëve të saj të cilët nuk jetojnë /nuk janë anëtarë efektivë prej një kohe të gjatë.	353,126
Anullimi të drejtave të pa arkëtueshme prej anëtarë të IEKA-s të cilët nuk jetojnë/nuk janë anëtarë efektivë prej një kohe të gjatë.	-813,929
Anullimi detyrimeve të hershme të IEKA-s me palët të treta, të cilat nëpërmjet konfirmimit direkt, rezultuan të likuiduara më parë.	4,455,142
Shtimi Aktive Materiale të IEKA-s dhe rillogaritur amortizimet përkatëse të pa regjistruar më parë.	764,349
Anullimi disa të drejtave të hershme të IEKA-s me palët të treta, të cilat nëpërmjet konfirmimit direkt, rezultuan të arkëtuara më parë.	-132,950
Korrigjime të paraqitjeve të gabuara të pasqyrave financiare në vitin 2021	-69,682
Efekti në Pasurinë neto	4,556,056

- Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur rishpërndarje të buxhetit për shpenzimet, të kryera me vendim të KD, por realizimi i disa zërave të buxhetit është tejkaluar, sipas analizës së paraqitur më lart. Referuar statutit, KD duhet të informohet në bazë tremujore mbi realizimin e buxhetit (26.5) dhe të monitorojë punën e stafit ekzekutiv në zbatimin e buxhetit të Institutit (15.2.17). Në vijim KD Autorizon transferimin e zërave të buxhetit përpara kryerjes së shpenzimeve deri në masën 25 % të zërit përkatës (15.2.27). Informimi në kohë mbi gjendjen financiare të IEKA-s është një masë preventive ndaj çdo rreziku apo mundësisë së keqpërdorimit të burimeve të Organizatës.

Organizimi dhe funksionimi i komiteve. Gjatë vitit 2023 janë hartuar rregulloret për funksionimin e komiteve, të paraqitura më poshtë, të cilat janë aprovuar në Asamblenë e Përgjithshme të organizuar në dhjetor 2023 dhe janë dërguar për shqyrtim dhe aprovim nga BMP. BMP i ka kthyer për rishqyrtim. Rregulloret dhe statusi i tyre aktualisht është si më poshtë:

- Rregullorja e Komitetit të Investigimit dhe Disiplinës, e cila tashmë ka plotësuar kërkesat e BMP.
- Rregullorja e Komitetit të Kontrollit të Cilësisë (KKC)
- Rregullorja e Komitetit të Standardeve Profesionale dhe Etikës (KSPE)
- Rregullorja e Komitetit të Programeve Alternative dhe Metodologjisë së Auditimit (KPAMA)

Pavarësisht hartimit të rregulloreve, nga analiza e buxhetit e kryer më lart, mund të konkludohet lehtësisht se disa nga komitetet e krijuara nuk kanë qenë plotësisht funksionale. Ndërkaq që “Komiteti Programeve Alternative dhe Metodologjisë së Auditimit” nuk ka kryer asnjë aktivitet gjatë vitit 2023. Për rrjedhojë, rekomandimi i lënë për disa vite rradhazi mbetet në fuqi.

Në këtë pikë vlen për t’u përmendur se gjatë vitit 2023 është organizuar dhe miratuar “Grupi i Punës” për rishikimin e statutit të IEKA-s, i cili ka dalë me propozime për ndryshimin e statutit që kanë si synim të sigurojnë vazhdimësinë e aktivitetit normal të IEKA-s duke u përshtatur me zhvillimet më të fundit. Statuti me ndryshimet përkatëse pritet të paraqitet për miratim në mbledhjen e radhës të Asamblesë së Përgjithshme.

Botimet dhe përkthimet. Pavarësisht rëndësisë së këtij aktiviteti për mbarëvajtjen e punës së të gjithë anëtarëve dhe kontributin të cilin mund të ketë në rritjen e aftësive dhe njohurive të tyre, botimet dhe përkthimet mbeten një fushë ende e paeksploruar. Duhet theksuar në këtë pikë se gjatë vitit 2023 IEKA ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me anëtarët e saj duke i informuar dhe përditësuar nepërmjet e-mail-it me shumë udhëzime, guida dhe materiale të vlefshme për auditim. Gjithashtu, IEKA ka publikuar në faqen e web materiale të ndryshme udhëzuese dhe informuese të marra nga IFAC.

Rishikimi, plotësimi dhe përditësimi i rregullores së brendshme dhe i organigramës së IEKA-s. Lidhur me këtë pikë gjatë 2023 janë plotësuar mungesat e stafit sipas strukture organizative, rregullores së brendshme të IEKA-s dhe prioritetet e saj. Me konkretisht, duke marrë parasysh që një ndër objektivat kryesore të punës së IEKAs mbetet kontrolli i zbatimit të kërkesave të SNA-ve, është shumë i rëndësishëm përdorimi i instrumenteve të kontrollit të cilësisë. Për këtë arsye struktura e IEKA-s në nëntor të vitit 2023 është plotësuar me dy Inspektor të Kontrollit të Cilësisë: Z. Xhoxhi Lera ish Auditues Ligjor me eksperiencë shumëvjeçare, dhe Z. Orjal Shaholli, Auditues Ligjor i cili ka kaluar me status pasiv. Fokusi i IEKA-s mbetet marrja nga BMP e delegimit të kontrollit të cilësisë për auditimet e njësive ekonomike të cilat nuk janë me interes publik, sipas legjislacionit në fuqi.

Inventari fizik i aktiveve afatgjata dhe vlerësimi i drejtë i tyre. Gjatë vitit është kryer inventarizimi dhe janë identifikuar diferencat, përfshirë këtu aktive materiale të cilat mungojnë si dhe aktive materiale ekzistuese të cilat nuk ishin njohur dhe regjistruar më parë në kontabilitet. Megjithatë procesi ka nevojë për përmirësime dhe rekomandimi lidhur me kodifikimin dhe rivlerësimin mbetet në fuqi.

Organizimi i kontabilitetit të IEKA-s, sipas kërkesave të SKK-së për OJF-të dhe Udhëzuesit për OJF-të, i ndryshuar.

Që të arrihet qëllimi që pasqyrat financiare të jenë të “sakta” dhe “të plota” (në lidhje me ngjarjet ekonomike), “të arsyeshme” dhe “të logjishme” (në lidhje me vlerësimet), dhe “të mjaftueshme” dhe “të detajuara” (në lidhje me shënimet e pasqyrave) dhe në respektimin e kërkesave të ligjit mbi **Kontabilitetin** dhe kuadrin e përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare sipas SKK1, kërkohet (të ripërsëritura):

- Të diskutohet dhe të vendoset për kontabilizimin e të ardhurave çdo tre muaj;
- Të kryhet puna e krijimit dhe e rakordimit të bazës së plotë të të dhënave në lidhje me detyrimet e anëtarëve aktivë dhe pasivë të IEKA-s, e cila duhet të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme për shlyerjet e realizuara gjatë vitit.
- Të bëhet një analizë e thelluar dhe e detajuar për të identifikuar në nivel individual të gjitha detyrimet e prapambetura dhe kohën e krijimit të tyre. Në vijim të kërkohet shlyerja e të gjitha detyrimeve të

prapambetura si të AL-ve ndaj IEKA-s ashtu dhe të detyrimeve të IEKA-s ndaj AL-ve .

- Të ndryshohen afatet e dorëzimit të misionëve të kryera dhe e pagesave të kuotave variabël në IEKA. Raportimi i misionëve të vitit korent dhe pagesat e detyrimeve për kuotën variabël të periudhës të bëhen deri me dt.31 dhjetor të atij viti. Rakordimi përfundimtar të kryhet në janar të vitit pasardhës vetëm për diferencat e mundshme të vitit të mbyllur.
- Të dorëzohet raporti i performancës së OJF-së bashkë me pasqyrat financiare, i detyrueshëm për t'u dorëzuar sipas SKK-së në zbatim të ligjit nr. 25/2018². Ky raport nuk është hartuar dhe nuk është dorëzuar nga IEKA as në organet fiskale dhe as para KKB-së.

b) Rekomandime

Komiteti i Kontrollit të Brendshëm ka kryer një kontroll mbi ndryshimet dhe korigjimet e kryera në kontabilitetin e Institutit gjatë vitit 2023 nga stafi ekzekutiv. Në këtë kuadër, do të donim të përgëzonim stafin ekzekutiv për të gjithë punën e detajuar të kryer në identifikimin e hollësishëm të të drejtave dhe detyrimeve të prapambetura. Ndërkaq, më poshtë paraqesim rekomandimet tona në lidhje me përmirësime të mëtejshme të cilat duhen ndërmarrë për të rritur efikasitetin dhe sigurinë në mbledhjen në kohë dhe mirë-menaxhimin e fondeve dhe të aktiviteteve të Institutit.

Bazuar në problemet e vëna në pah në këtë raport, KKB-ja rekomandon:

- Të ndryshohen afatet e dorëzimit të misionëve të kryera dhe e pagesave të kuotave variabël në IEKA.
- Raportimi i misionëve të vitit korent dhe pagesat e detyrimeve për kuotën variabël të periudhës të bëhen çdo tre muaj, deri me datë 31 dhjetor të çdo viti. Rakordimi përfundimtar të kryhet në janar të vitit pasardhës vetëm për diferencat e mundshme të vitit të mbyllur.
- Të merren masat që raportimi dhe arkëtimi i detyrimeve ndaj IEKA-s, të bëhet nga të gjithë AL-të. Të ketë ndjekje individuale për detyrimet e të gjithë AL-ve ndaj IEKA-s.
- Të diskutohet dhe të propozohet mënyra për mbledhjen e kuotave të AL-ve pasivë.
- Zbatimi i Statutit lidhur me zbatimin e penaliteteve dhe masave shtrënguese për AL-të dhe shoqëritë e auditimit që nuk i kryejnë në kohë apo dhe që nuk i shlyejnë detyrimet ndaj IEKA-s.
- Duhet të vendoset të bëhet rivlerësimi i ndërtesës për përcaktimin e vlerës së drejtë të saj, pas një vlerësimi të mundësive dhe nxjerrjen e drejtë dhe të aktiveve neto të IEKA-s.
- Të merret vendimi nga KD-ja për vlerësimin e drejtë të amortizimit të aseteve dhe regjistrimin në kontabilitet të vlerave të pranuar të dt 31.12.2021, gjithnjë për nxjerrjen e drejtë dhe të aktiveve neto të IEKA-s.

Rishikimi i rregullores për forcimin e disiplinës financiare për përdorimin e pasurisë së IEKA-s. Për këtë, ndër të tjera, kërkohet:

- Të krijohet struktura e auditimit të brendshëm ose të lidhet kontratë me një studio auditimi.
- Të krijohet Komiteti i Auditimit që do të monitorojë auditimin e brendshëm dhe auditimin e jashtëm, në përputhje me kërkesat që IEKA, si OJF me interes publik, duhet të realizojë ne
- Të shkruhen procedurat për funksionimin dhe qarkullimin e dokumentacionit për secilën njësi të strukturës ekzekutive të IEKA-s sipas një protokollit të brendshëm.
- Këshilli i Drejtimit të hartojë kontratat individuale të punës në përputhje me detyrat funksionale të çdo punonjësi të stafit ekzekutiv, detyra të përcaktuara dhe të saktësuara dhe në organigramën e IEKA-s.
- Këshilli i Drejtimit të rishikojë e të përditësojë vendimet e tij, mbi bazën e të cilave rregullohet veprimtaria operationale dhe e vendim-marrjes së IEKA-s.
- Këshilli i Drejtimit duhet të ndjekë rregullisht realizimin e buxhetit dhe të marrë vendime bazuar në

²<https://www.kkk.gov.al/foto/uploads/File/Udhezuesi%20per%20raportin%20e%20performances%20publikuar.pdf> Page 28 nga 32

statutin e IEKA-s për rishpërndarjen e fondeve sipas nevojave dhe situatave specifike.

- Drejtori Ekzekutiv në bashkëpunim me KD-në duhet të bëjë rishikimin e projekt- buxhetit 2024, bazuar në realizimet e vitit 2023 me qëllim që të reflektojë ndryshimet të cilat kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.
- Format i raportimit të projekt-buxhetit duhet të përditësohet për të reflektuar ndryshimet lidhur me disa zëra të cilët kanë nevojë për më tepër detaje. Gjithashtu, ai duhet të përshtatet me raportet e tjera të përgatitura nga IEKA, duke siguruar pajtueshmëri midis raporteve, gjë që do të lehtësojë dhe lexuesin dhe stafin ekzekutiv që përgatit këto raporte.
- Saktësimi i kriterëve për dhënien e ndihmave, shpërblimeve dhe shumave të tjera monetare për stafin ekzekutiv, duke rishikuar e korrigjuar vendimet e kaherëshme të tij me vlerën e pagave bruto që merren sot prej stafit.
- Çdo pagesë që do të kryhet duhet të shoqërohet me dokumentet që vërtetojnë kryerjen e plotë dhe në kohën e duhur të detyrave funksionale të punonjësve të stafit ekzekutiv.
- Të krijohet mundësia e pajisjes me karta elektronike e punonjësve në mënyrë që të monitorohet të hyrja e dalja, prezenca në punë dhe koha efektive e punës së kryer.
- Saktësimi i kriterëve për dhënien e ndihmave, shpërblimeve dhe shumave të tjera monetare për AL-të aktivë dhe për ata që kanë mbushur moshën e largimit, sipas rregullave qartësisht të përcaktuara.
- Çdo blerje e vogël e kryer në emrin dhe për llogari të IEKA-s (për pritje e përcjellje, për pastrim etj) të bëhen me fatura të fiskalizuar me NIPT-in e IEKA-s.

Organizimi dhe funksionimi i komiteve. Sikurse është përmendur më lart, gjatë vitit 2023 janë hartuar rregulloret për secilin komitet, të cilat duhet të përditësohen për tu përputhur me kërkesat e BMP dhe të bëhen efektive.

Rekomandimi ynë kryesorë lidhet me funksionimin e rregullt të komiteve dhe me transparencë të plotë ndaj Anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme për aktivitetin e tyre gjatë vitit. Për vitin 2023, sikurse detajuar më lart, jo të gjitha komitetet kanë qenë plotësisht funksionale dhe për një pjesë të tyre nuk kemi marrë një raport vjetor i cili të përshkruaj aktivitetet dhe punën e kryer.

Botimet dhe përkthimet. Botimet dhe përkthimet e standardeve të reja, interpretimet e tyre dhe çdo përditësim në fushën e auditimit, mbetet një nga shtyllat kryesore që siguron mbarëvajtjen e profesionit të Audituesit Ligjor. Për këtë arsye, një vëmendje e veçantë duhet dhënë kësaj fushe, e cila për momentin vazhdon të mbetet jashtë fokusit të IEKA-s.

VIII. Aneks I

	Zërat e Buxhetit	Projekt Buxheti 2023	Realizimi 2023	Realizimi Buxhetit në %	Realizimi Buxhetit në vlerë absolute	Projekt Buxheti 2024
1	Burimet	32,500,000	34,007,903	104.64%	1,507,903	32,500,000
1.1	Burime financiare nga Aktiviteti	28,000,000	29,015,704	103.43%	1,015,704	29,000,000
1.1.1	Kuota fikse e anëtarësimit	16,000,000	15,844,976	98.93%	-155,024	16,000,000
1.1.2	Kuota variable e misionëve	9,000,000	10,970,268	121.45%	1,970,268	10,000,000
1.1.3	Të ardhura nga regjistrimi kandidatëve	1,500,000	1,296,015	86.40%	-203,985	1,500,000
1.1.4	Të ardhura të tjera & Regj. Shoqërive)	1,500,000	904,445	60.30%	-595,555	1,500,000
1.2	Burime të ardhurash të tjera	4,500,000	4,992,199	110.94%	492,199	3,500,000
1.2.1	Burime (të ardhura) nga Botimet	0	28,000		28,000	0
1.2.2	Burime (të ardhura) nga kual. AL	400,000	1,519,082	379.77%	1,119,082	400,000
1.2.3	Burime (të ardhura) nga kualifikimit Kandidatëve	4,000,000	3,018,010	75.45%	-981,990	3,000,000
1.2.4	Burime nga trajnimi i SKK/SNK	0	0	0	0	0
1.2.5	Të ardhura nga depozitat e kursimeve	100,000	396,513	396.51%	296,513	100,000
1.2.6	Fitime/humbje kursi këmbimit	0	30,594	NA	30,594	0
2	Përdorime (Shpenzime)	32,260,000	30,815,819	91.40%	-1,444,181	33,166,000
2.1	Shpenzime nga veprimtaria	28,460,000	27,120,329	90.62%	-1,339,671	29,166,000
2.1.1	Pagat e punonjësve	11,700,000	10,183,418	87.04%	-1,516,582	11,800,000
2.1.1.1	Pagat e personelit me kohë të plotë	10,000,000	8,806,247	88.06%	-1,193,753	10,000,000
2.1.1.2	Sigurime shoqërore	1,700,000	1,222,319	71.90%	-477,681	1,800,000
2.1.1.3	Pagat personeli me kohë pjesëshme, shperblime	0	154,852	NA	154,852	0
2.1.2	Honorare të Drejtimit	4,800,000	4,408,000	91.83%	-392,000	4,596,000
2.1.2.1	Honorare të KD&drejtimit përditshem	3,000,000	3,000,000	100.00%	0	3,000,000
2.1.2.2	Pagesë për mbledhje të KD	1,500,000	1,108,000	73.87%	-392,000	1,296,000
2.1.2.3	Komiteti i Kontrollit të Brendshëm	300,000	300,000	100.00%	0	300,000
2.1.3	Honorare për Autoritete e Komitete	2,950,000	1,628,525	55.20%	-1,321,475	3,900,000
2.1.3.1	Komiteti i Regjistrimit	450,000	456,725	101.49%	6,725	400,000
2.1.3.2	Komiteti i Investigimit & Disiplinës	350,000	136,000	38.86%	-214,000	500,000
2.1.3.3	Komiteti i Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshem	700,000	726,800	103.83%	26,800	800,000
2.1.3.4	Komiteti i Kontrollit të Cilësisë për Auditimin Ligjor & Sherbimet e lidhura	400,000	236,000	59.00%	-164,000	600,000
2.1.3.5	Komiteti Standarteve Profesionale & Etikes	400,000	68,000	17.00%	-332,000	600,000

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm Viti 2023

	Zërat e Buxhetit	Projekt Buxheti 2023	Realizimi 2023	Realizimi Buxhetit në %	Realizimi Buxhetit në vlerë absolute	Projekt Buxheti 2024
2.1.3.6	Komiteti Programeve Alternative & Metodologjise se Auditimit	400,000	5,000	1.25%	-395,000	600,000
2.1.3.7	Komiteti Revistës , perkthime	250,000	0	0.00%	-250,000	400,000
2.1.4	Shpenzime të Administrimit	8,210,000	9,785,586	102.99%	1,575,586	8,070,000
2.1.4.1	Telefon, Fax, shpenzime interneti	300,000	575,301	191.77%	275,301	300,000
2.1.4.2	Mirëmbajtja e regj. publik & faqes interneti	300,000	0	0.00%	-300,000	360,000
2.1.4.3	Energji, Ujë.	250,000	170,019	68.01%	-79,981	300,000
2.1.4.4	Kancelari, Shtypshkrime, riparime	250,000	249,716	99.89%	-284	300,000
2.1.4.5	Reklama, Publicitet, Njoftime	0	0	NA	0	0
2.1.4.6	Abonime, Gazeta, revista	0	23,175	NA	23,175	0
2.1.4.7	Udhëtime e Dieta	1,000,000	606,834	60.68%	-393,166	1,000,000
2.1.4.8	Karburant e rip. të zakonshme	400,000	300,410	75.10%	-99,590	300,000
2.1.4.9	Taksa, sigurime e parkim automjesh	200,000	67,249	33.62%	-132,751	200,000
2.1.4.10	Shpenzime pritjeje	200,000	182,175	91.09%	-17,825	200,000
2.1.4.11	Shërbime në të tretë	150,000	561,184	374.12%	411,184	150,000
2.1.4.12	Regjistrime në organet lokale	180,000	129,092	71.72%	-50,908	180,000
2.1.4.13	Shpenzime për kom. Bankare	200,000	275,183	137.59%	75,183	200,000
2.1.4.14	Kuota anëtarësimi Org. Nd/kombëtare	1,500,000	1,485,230	99.02%	-14,770	1,500,000
2.1.4.15	Shpenzime të tjera	200,000	10,535	5.69%	-189,465	300,000
2.1.4.16	Shpenzime për Asamblenë+feste fundviti+25 vjet	600,000	1,155,400	192.57%	555,400	800,000
2.1.4.17	Auditimi i PF	280,000	280,850	100.00%	850	280,000
2.1.4.18	Shpenzime amortizimi	1100000	1,291,449.67	117.40%	191,450	1100000
2.1.4.19	Shpenzime të paparashikuara	100,000	1,751,413	421.47%	1,651,413	100,000
2.1.4.20	Shpenzime Konsulence ligjore	1,000,000	670,370	67.04%	-329,630	500,000
2.1.5	Investime, Meremetime	800,000	1,114,800	139.35%	314,800	800,000
2.1.5.1	Investime (blerje AAM dhe meremetime)	800,000	1,114,800	139.35%	314,800	800,000
2.1.6	Rezervë e KD gjithsej	500,000	0	0.00%	-500,000	500,000
2.2	Shpenzime për botime/perkthime	800,000	0	0.00%	-800,000	800,000
2.2.1	Botimi i SNA, KE etj.	400,000	0	0.00%	-400,000	400,000
2.2.2	Tekstet Kaplan te ACCA	400,000	0	0.00%	-400,000	400,000
2.2.3	Botimi i Revistes & Libra	0	0	0%	0	0
2.3	Shpenzime për kualifikimin	3,000,000	3,654,776	121.83%	654,776	3,200,000

INSTITUTI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR (IEKA)
Raport i Komitetit të Kontrollit të Brendshëm Viti 2023

	Zërat e Buxhetit	Projekt Buxheti 2023	Realizimi 2023	Realizimi Buxhetit në %	Realizimi Buxhetit në vlerë absolute	Projekt Buxheti 2024
2.3.1	Shpenzime kualifikimi i kandidatëve	2,100,000	2,284,955	108.81%	184,955	2,200,000
2.3.2	Shpenzime kualifikimi i AL	900,000	1,369,821	152.20%	469,821	1,000,000
2.3.3	Shpenzime trajnimi i SKK/SNK	0	0	0%	0	0
2.4	Fitime/humbje kursi këmbimit	-	40,714	NA	40,174	-
2.5	Aktiviteti sipas vendimit Asamblese(udhetime jashte shtetit per anearet e asamblese)	-	-	-	-	-
	Teprica	240,000	3,192,084	1860.80%	2,952,084	-666,000
4.1	Shpenzime për tarifen 7% për BMP	2,000,000	2,114,532	106%	-114,532	2,000,000
	Teprica përfshirë Tarifen 7%	-1,760,000	1,077,552	-133.60%	-4,111,380	-2,666,000

KOMITETI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Atin Sulejmani
Kryetar



Fatmira Kastrati
Anëtar



Eljona Hoxha
Anëtar



